



KËSHILLI I LARTË GJYQËSOR

V E N D I M

Nr. 19, datë 29.01.2019

MBI

PËRBËRJEN E KOMISIONIT TË PËRKOHSHËM PËR VERIFIKIMIN E PLOTËSIMIT TË KRITEREVE TË KANDIDATËVE PËR KËSHILLTARË DHE NDIHMËS LIGJORË

Këshilli i Lartë Gjyqësor, i mbledhur sot më datë 29.01.2019, bazuar në nenin 62, pika 14 të ligjit nr.115/2016, “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë”, si dhe në vendimin nr. 18, datë 29.01.2019, “Për ngritjen e Komisionit të Përkohshëm për Verifikimin e Plotësimit të Kriterëve të Kandidatëve për Këshilltarë dhe Ndhmës Ligjorë, që do të pranohen për të ndjekur për një periudhë prej nëntë muajsh programin e formimit fillestar pranë Shkollës së Magjistraturës, për vitin akademik 2019-2020”,

V E N D O S I:

1. Komisioni i Përkohshëm për Verifikimin e Plotësimit të Kriterëve të Kandidatëve për Këshilltarë dhe Ndhmës Ligjorë, që do të pranohen për të ndjekur për një periudhë prej nëntë muajsh programin e formimit fillestar pranë Shkollës së Magjistraturës, për vitin akademik 2019-2020 përbëhet nga:
 - Z. Erjon Muharremaj – Kryetar,
 - Znj. Brunilda Kadi – anëtare,
 - Znj. Brikena Ukperaj (Lubonja) – anëtare.
2. Komisioni i Përkohshëm të përmbushë detyrat dhe të respektojë afatet e përcaktuara në vendimin nr. 18, datë 29.01.2019, të Këshillit të Lartë Gjyqësor.
3. Ky vendim hyn në fuqi në datën e botimit në faqen zyrtare të Këshillit të Lartë Gjyqësor.

PËR KËSHILLIN E LARTË GJYQËSOR